

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 20 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP.nr.145/2010 të datës 04.03.2010, pas mbajtjes së seancës kryesore publike në praninë e Prokurorit të Shtetit Beqë Shala dhe të akuzuarit, me datë 17.08.2015 morri dhe shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**B. M.** nga i ati H., dhe e ëma Q. e lindur Xh., i lindur më datë “data e lindjes..” në Prizren ku edhe tani jeton rruga “..... ..” nr. ... , ka të kryer shkollën e mesme, shitës ambulator, i martuar, babë i një fëmije, me numër të kartelës së identifikimit ..... , i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 16.08.2007, rreth orës 12:25 minuta, në Prizren, i akuzuari me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete tenton të ia marr pasurinë e luajtshme të tjetrit duke kapërcyer pengesat në atë mënyrë që kapërcen telat të rrethojës dhe hynë në kazermën e KFOR – it, në lagjen ..... , ku pasi që kalon 50 metra në brendësi, ndalohej nga ana e ushtarëve të KFOR – it Gjerman.

**Kësodore ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 20 të KPK.**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 49, 50, 52, 73 dhe nenit 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 20 të KPK i shqiptoi:

### DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 2 (dy) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari KFOR – Gjerman nëpërmjet autorizuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.145/2010 të datës 04.03.2010, kundër të akuzuarit B. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 20 të KPK.

Prokurori Shtetit Beqë Shala në fjalën përfundimtare deklaroi se mbete në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.145/2010 të datës 04.03.2010, kundër të akuzuarit B. M. nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 20 të KPK dhe atë duke pasur parasysh faktin se këtu i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë e cila është në pajtim me provat materiale në të cilat mbështetet aktakuza. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari B. M. në fjalën përfundimtare deklaroi se veprën penale për të cilën akuzohet ka kryer nga pakujdesia respektivisht nga mos dija sepse nuk ka qenë në dijeni se zona në fjalë është pronë e personit tjetër konkretisht KFOR – it. Qëllimi i tij nuk ka qenë vjedhje e sendeve por vetëm kureshtja që ta vizitoj objektin në fjalë. Andaj nga gjykata kërkon që të ketë parasysh këtë fakt dhe ndaj tij të shqiptoj një dënim sa më të butë pasi që është mbajtës i vetëm i familjes dhe pendohet për veprimet të cilat i ka ndërmarr. Tani është person që është kthyer jetës normale dhe mjete financiare e siguron nga puna e tij si shitës në treg.

Gjykata në shqyrtimin kryesor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në ditën kritike me datë 16.08.2007 rreth orës 12:25 minuta në Prizren i akuzuari B. M. duke i kapërcyer telat e kazermës së KFOR – it, në lagjen ..... , hynë në brendinë e kazermës, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete tenton të ia merr pasurinë e luajtshme të tjetrit, ku pasi depërton në brendi diku pas 50 m, ndalohet nga ana e ushtarëve të KFOR – it. Me ç'rast ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 253 par.1 nën par.1 lidhur me nenin 20 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit i cili në shqyrtimin kryesor vullnetarisht ka pranuar për veprën penale me të cilën ngarkohet, me ç'rast edhe gjykata nuk ka administruar prova. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari pas pranimit vullnetar të fajësisë, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë vullnetarisht, sepse i njëjti mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza ngase se i akuzuari prej fillimit të procedurës ka qenë i njoftuar të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat ligjore dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të

akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në rastin konkret gjykata duke mos gjetur rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se i akuzuari ka pranuar fajësinë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, gjendja ekonomike dhe statusore pasi që është mbajtës i vetëm i familjes, andaj bazuar në të gjitha këto gjykata i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla, me bindje se dënimi është proporcionale me peshën e veprës penale për të cilën i akuzuarit është shpallur fajtor.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.480/2010 të datës 17.08.2015**

**Procesmbajtësja**  
**Myrvete Përdibuka**

**Gjyqtarja**  
**Teuta Krusha**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.